



UNMIK/REG/2004/49  
26 nëntor 2004

---

**RREGULLORE NR. 2004/49**

**MBI VEPRIMTARITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT,  
KANALIZIMIT DHE TË MBETURINAVE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nr. 1999/1 të datës 25 qershor 1999 mbi Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në përputhje me nenin 8.1 (q) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001) dhe pas konsultimit me Qeverinë,

Duke marrë parasysh përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Me qëllim të themelimit të Zyrës rregullative të ujësjellësit dhe mbeturinave dhe përcaktimit të kornizës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve në pronësi shoqërore dhe publike të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë, duke përfshirë ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit, trajtimin e lidhjeve të kundërligjshme dhe shlyerjen e borxheve ndaj ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave,

Me anë të kësaj shpall

**Kapitulli 1**  
**Fushëveprimi dhe përkufizimet**

Neni 1

## Fushëveprimi i zbatimit dhe themelimi i rregullatorit

1.1 Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve në pronësi publike e shoqërore dhe furnizuesve të ujit me shumicë në Kosovë dhe drejton standardet e shërbimeve, caktimin e tarifave, statutin e konsumatorëve, nxjerrjen, ndryshimin dhe tërheqjen e lejeve për shërbime, ndërprerjet dhe lidhjet e kundërligjshme, si dhe shlyerjen e borxheve të vjetra.

1.2 Me anë të kësaj themelohet Zyra rregullative e ujësjellësit dhe e mbeturinave (në tekstin e mëtejshëm “Rregullatori”) si një organ i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese. Rregullatori e ka drejtorin, zëvendësdrejtorin e kuadrin profesional dhe nëpunësit. Drejtori dhe zëvendësdrejtori emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) me rekomandim të Zëvendëspërfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (ZSSP) për zhvillim ekonomik dhe rindërtim dhe pas konsultimeve me Qeverinë.

1.3 Rregullatori është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve në pronësi shoqërore dhe publike të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë. Rregullatori merr vendime të pavarura gjatë ushtrimit të përgjegjësisë në bazë të kësaj Rregulloreje dhe në çdo kohë i përgjigjet PSSP-së për përputhshmërinë me:

- (a) Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,
- (b) Dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe ndonjë rregulloreje, urdhërese administrative, udhëzimi administrativ ose vendimi tjetër të cilin mund ta nxjerrë PSSP-ja lidhur me këtë rregullore,
- (c) Ndonjë ligj tjetër të zbatueshëm në Kosovë.

### Neni 2 Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje vlejné këto përkufizime të mëposhtme:

“Periudhë e faljes” në lidhje me lidhjet e kundërligjshme do të thotë periudha prej katër (4) muajve prej datës kur hyn në fuqi kjo Rregullore;

“Ujë i papërpunuar” do të thotë uji i cili nuk është përpunuar për të qenë i përshtatshëm për t’u konsumuar nga njerëzit;

“Furnizues i ujit të papërpunuar” do të thotë çdo person i cili e furnizon ofruesin e shërbimeve të ujësjellësit me ujë të papërpunuar;

“Tarifë e ujit të papërpunuar” do të thotë çdo shkallë, ngarkesë apo pagesë e furnizuesit të ujit të papërpunuar lidhur me furnizimin e ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit me ujë të papërpunuar;

“Ndërprerje kolektive” do të thotë ndërprerje e njëkohshme e një grupi të caktuar në pajtim me nenin 22 në të cilin kontekst “ndërprerja kolektivisht” ka kuptim të ngjashëm;

“Plan për konsolidim” do të thotë plani për ristrukturimin e sektorit të themeluar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (“AKM”) për konsolidimin dhe ristrukturimin e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ofruesve të shërbimeve të mbeturinave të ngurta i datës 10 shtator 2002 i cili është ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar kohë pas kohe nga AKM-ja;

“Konsumator” do të thotë personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose të cilit i janë ofruar shërbime nga ofruesi i shërbimeve;

“Statut i konsumatorëve” do të thotë rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1 (e);

“Komision konsultativ i konsumatorëve” do të thotë komisioni i përshkruar dhe i themeluar në pajtim me nenin 17;

“Ndërprerje” do të thotë ndërprerje e lidhjes mes objektit të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të shërbimeve të ujësjellësit e cila i mundëson konsumatorit ofrimin e këtyre shërbimeve prej ndonjë ofruesi të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe “ndërprerës” ka kuptimet e ngjashme;

“Deponi” do të thotë vendi ose lokacioni i licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për mbeturina të ngurta dhe ndonjë lëndë të mbetur pas përpunimit të mbeturinave të ngurta komunale dhe pas përfundimit të rigjenerimit të produkteve ose energjisë;

“Kontest në mirëbesim” do të thotë kontesti lidhur me ndonjë faturë të nxjerrë nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit që është inicuar me shkrim nga konsumatori, me kusht që shumica e përgjithshme që duhet të paguhet ta tejkalojë së paku për dhjetë për qind (10%) harxhimin mesatar sezonal të paguar nga ky konsumator gjatë periudhës prej dymbëdhjetë (12) muajve para datës së faturës dhe që kontesti të mos jetë i paarsyeshëm apo i bezdisshëm;

“Konsumator i ndërgjegjshëm” do të thotë konsumatori i cili i ka paguar faturat e pakontestueshme brenda një muaji kalendarik prej datës kur këto fatura është dashur të paguheshin ose ka lidhur marrëveshje edhe për pagesë me ofruesin e shërbimeve të ujësjellësit e kanalizimit dhe i është përmbajtur asaj;

“Paradhënie” do të thotë depozit i kërkuar nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në pajtim me nenin 27;

“AKM” do të thotë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit;

“Lidhje e ligjshme” do të thotë:

- (i) lidhja mes objektit të konsumatorit që ndodhet në regjistrin e konsumatorëve dhe rrjetit shpërndarës për shërbimet e ujësjellësit të kryera nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit ose
- (ii) lidhja mes objektit të ndonjë personi dhe rrjetit të shpërndarjes të vendosur nga ofruesi përkatës i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit apo pararendësve të tij në përputhje me ligjin në fuqi,

në të cilin konteksti “i lidhur në mënyrë të ligjshme” ka kuptim të ngjashëm;

“Shpenzime marginale afatgjata” do të thotë shpenzime të cilat i bën ofruesi i shërbimeve apo furnizuesi me ujë të papërpunuar për një njësi shtesë të kapacitetit, duke përfshirë shpenzimet kapitale dhe shpenzimet tjera të cilat nuk paraqesin shpenzime të atypëratyshme të nevojshme për krijimin e një kapaciteti më të lartë;

“Komunë” do të thotë komunat e përcaktuara në tabelën A të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/43 të datës 27 korrik 2000 për numrin, emrat dhe kufinj të komunave;

“Mbeturina të ngurta komunale” do të thotë mbeturinat e ngurta, të cilat nuk janë mbeturina të rrezikshme, mbeturina medicinale apo mbeturina helmuese që dalin prej ekonomive familjare, tregtisë, institucioneve ose industrisë dhe mbeturinat e përpunuara;

“Ujë i pashitur” do të thotë sasia e ujit të mbetur pasi të jetë zbritur sasia e ujit të shitur prej ujit të prodhuar;

“Borxh i vjetër” do të thotë borxhi i konsumatorit i dokumentuar me anë të faturave të pakontestuara të lëshuara nga ofruesi i shërbimeve për atë konsumator më 31 dhjetor ose para 31 dhjetor 2002, të cilat nuk janë paguar në tërësi;

“Marrëveshje për pagesë” do të thotë marrëveshja për të paguar një shumë që duhet paguar dhe që është borxh ndaj ofruesit të shërbimeve e bërë ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve në pajtim me nenin 31;

“Person” do të thotë individi, subjekti juridik a publik, duke përfshirë korporatën, ortakërinë, trustin, ndonjë organizatë të painkorporuar, qeverinë ose ndonjë agjenci a nënndarje të tyre;

“Shpallje publike” do të thotë njoftimi në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe lidhur me ndërprerjen kolektive të propozuar e cila publikohet në formën e përcaktuar me anë të rregullave të nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1(g) dhe të publikuara në mediat rajonale apo komunale të cilat në mënyrë të arsyeshme llogariten të arrijnë deri te grupi i caktuar;

“Grup i caktuar” do të thotë grupi i konsumatorëve në një hapësirë gjeografike të caktuar të cilët shfrytëzojnë një lidhje të përbashkët apo pika të përbashkëta të furnizimit prej ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, prej të cilëve së paku 51 për qind (51%) përbën konsumatorët e pandërgjegjshëm;

“Rajon” do të thotë hapësira e përkufizuar me anë të planit për konsolidim e cila përfshin një komunë të tërë ose ndonjë pjesë të komunave të tjera;

“Rregullator” do të thotë organ përgjegjës për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve në bazë të ligjit në fuqi;

“Komision shqyrtues” do të thotë komisioni i cili mund të shqyrtojë vendimet e Rregullatorit në pajtim me nenin 34;

“Shërbim” do të thotë çdonjëri prej shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave, shërbimet për hedhjen e mbeturinave, shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit ose furnizimi i ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit me ujë të papërpunuar, të gjitha së bashku “shërbime”;

“Zonë e shërbimeve” në lidhje me lejen për shërbime do të thotë rajoni ose komuna brenda së cilës ofruesi i shërbimeve mund t’i ofrojë shërbimet e veta;

“Kontratë për shërbime” do të thotë marrëveshja mes ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorëve të tij nga neni 15, e nëse nuk ekziston kjo marrëveshje do të thotë kushtet e ofruesit të shërbimeve për furnizim;

“Leje për shërbime” do të thotë leja për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, leja për shërbimet e hedhjes së mbeturinave ose leja për shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit;

“Ofrues i shërbimeve” do të thotë ofruesi i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave, ofruesi i shërbimeve të hedhjes së mbeturinave ose ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit ose furnizuesi i ujit të papërpunuar, pra të gjitha së bashku janë “ofruesit e shërbimeve”;

“Standard i shërbimeve” në lidhje me ndonjë prej shërbimeve do të thotë standardet e shërbimeve që zbatohen për ato shërbime në përputhje me këtë Rregullore;

“Tarifë e shërbimeve” do të thotë cilado shkallë, ngarkesë ose pagesë e ofruesit të shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve të veta për konsumatorin;

“Lidhje e kundërligjshme” do të thotë lidhja mes objektit të ndonjë personi dhe rrjetit shpërndarës të shërbimeve të ujësjellësit të ofruara nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, e cila nuk është vendosur nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit apo nga pararendësit e tij në përputhje me ligjin në fuqi, dhe “i lidhur në mënyrë të kundërligjshme” ka kuptim të ngjashëm;

“Person i rrezikuar” do të thotë:

- (i) çdo person fizik jeta ose shëndeti i të cilit konsiderohet të jetë në rrezik pa shërbimet e ujësjellësit, me kusht që ky fakt të mund të vërtetohet nga ndonjë mjek i licencuar ose
- (ii) cilido konsumator i klasifikuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale si nevojtar dhe varfanjak i cili rast i është bërë me dije ofruesit të shërbimeve të

ujësjellësit dhe kanalizimit se gëzon të drejtën që faturat e tij t'i paguhen nga organet kompetente të mirëqenies sociale;

“Paralajmërim” do të thotë njoftimi me shkrim që i është dhënë ofruesit të shërbimeve nga Rregullatori në pajtim me nenin 33;

“Kohëzgjatje e paralajmërimit” do të thotë:

- (i) së paku dhjetë (10) ditë pune të përcaktuara në paralajmërim si afat brenda të cilit Rregullatori kërkon që të bëhen përmirësimet e duhura në rast të ndonjë shkeljeje të caktuar të nenit 32 apo të ndonjë rrethane tjetër e cila kërkon tërheqjen e lejes për shërbime,
- (ii) një afat më i shkurtër kohor nëse Rregullatori është i mendimit se ky afat më i shkurtër kohor është në interesin e përgjithshëm publik;

“Shërbime të mbledhjes së mbeturinave” do të thotë mbledhja e mbeturinave të ngurta komunale dhe bartja e tyre në deponi;

“Ofrues i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave” do të thotë cilido person i cili ofron ose ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave;

“Shërbime të hedhjes së mbeturinave” do të thotë funksionimi i deponisë;

“Ofrues i shërbimeve të hedhjes së mbeturinave” do të thotë cilido person i cili ofron ose ka për qëllim të ofrojë shërbime të hedhjes së mbeturinave;

“Ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit” do të thotë çdo person i cili ofron ose ka për qëllim të ofrojë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit;

“Shërbime të ujësjellësit” do të thotë grumbullimi, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për t’u konsumuar nga njerëzit dhe funksionimi i rrjeteve e pajisjeve punuese që përdoren për këtë qëllim dhe

“Shërbime të kanalizimit” do të thotë mbledhja, hedhja dhe përpunimi i ujit të përdorur dhe i ujërave të zeza.

Fjalët e përorura në cilëndo gjini në këtë Rregullore përfshijnë edhe gjininë e kundërt dhe fjalët në njëjës nënkuptojnë shumësin, ndërsa ato në shumës nënkuptojnë njëjësin, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe.

Referencat në nene janë referenca në nenet e kësaj Rregulloreje, përveç nëse shprehimisht thuhet ndryshe.

## **Kapitulli 2** **Leja për ofruesit e shërbimeve**

### Neni 3 Leja për shërbime

Në bazë të nenit 36, asnjë person nuk mund të ofrojë shërbime në Kosovë pa lejen për shërbime përkatëse.

### Neni 4 Kërkesat për përtëritjen e lejes për shërbime

4.1 Secili ofrues i shërbimeve i bën kërkesë Rregullatorit për marrjen e lejes për shërbime ose për përtëritjen e lejes për shërbime në formën e përcaktuar nga Rregullatori së bashku me dokumentet dhe informatat e përmendura në formularin e tillë.

4.2 Rregullatori ia konfirmon ofruesit të shërbimeve brenda pesë (5) ditëve të punës marrjen e kërkesës dhe dokumenteve të tjera, si dhe pagesën që e ka bërë te Rregullatori.

4.3 Rregullatori i shqyrton kërkesat për lëshimin ose përtëritjen e lejes për shërbime brenda afatit prej gjashtë (6) javësh pas marrjes së kërkesës. Vendimi lidhur me kërkesën nxirret pas këtij afati me kusht që Rregullatori të jetë i bindur se të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara për të marrë vendimin i janë sjellur nga ofruesi i shërbimeve. Rregullatori mund të kërkojë që ofruesi i shërbimeve të paraqesë informata dhe dokumente shtesë lidhur me kërkesën dhe vendimi lidhur me kërkesën merret nga Rregullatori pasi të shqyrtohen me kujdes të gjitha informatat dhe dokumentet shtesë.

4.4 Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë prej Rregullatorit përtëritjen e lejes së tij për shërbime vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (a) nëse leja për shërbime parasheh përtëritjen;
- (b) nëse ofruesi i shërbimeve i është përmbajtur kushteve të lejes për shërbime në të gjitha aspektet materiale dhe
- (c) nëse kërkesa është paraqitur së paku dy (2) muaj para datës kur skadon leja për shërbime.

### Neni 5 Lëshimi dhe përtëritja e lejeve

5.1 Rregullatori e lëshon ose e përtërit lejen për shërbime vetëm nëse është i bindur që:

(a) informatat në formular dhe informatat ose dokumentet tjera të paraqitura nga ofruesi i shërbimeve lidhur me kërkesën janë të sakta dhe të plota;

(b) pas konsultimit me AKM-në, lëshimi ose përtëritja e lejes për shërbime do të ishte në përputhje me planin për konsolidim dhe qëllimet e tij;

(c) ofruesi i shërbimeve është në gjendje të ofrojë shërbime të pranueshme në cilësi, seriozitet, siguri, shpenzime dhe me respekt për të drejtat e konsumatorëve të parapara në statutin e konsumatorëve ose në kontratën për shërbime;

(d) ofruesi i shërbimeve do të jetë në gjendje t'u përmbahet kushteve që zbatohen për lejen për shërbime në pajtim me nenin 6 dhe

(e) ofruesi i shërbimeve i ka marrë të gjitha lejet, pëlqimet dhe të gjitha autorizimet tjera të nevojshme nga organet përkatëse dhe u është përmbajtur atyre.

5.2 Nëse Rregullatori vendos që të mos ia lëshojë ose të mos ia përtërijë lejen për shërbime ndonjë ofruesi të shërbimeve, ai e njofton ofruesin e shërbimeve me shkrim për arsyet brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga marrja e vendimit.

#### Neni 6 Kushtet për leje

6.1 Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në rregullat e nxjerra në pajtim me nenin 38.1(b) zbatohen për secilën leje për shërbime. Duke marrë parasysh detyrat që kjo Rregullore ia ngarkon Rregullatorit këto kushte të përgjithshme për leje përfshijnë kushtet për ofruesit e shërbimeve që të:

(a) demonstrojnë përvojë profesionale adekuate menaxhuese, operative dhe teknike si dhe ekzistimin e resurseve për funksionimin dhe mbarëvajtjen e pajimeve punuese dhe për ofimin e shërbimeve sipas standardeve të shërbimeve dhe standardeve komerciale të parapara në statutin e konsumatorëve;

(b) dëshmojnë aftësinë financiare për të paguar në kohën e bërjes së kërkesës dhe potencialin për të qenë financiarisht të qëndrueshëm gjatë tërë kohëzgjatjes së lejes për shërbime;

(c) pranojnë përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e një vargu të tërë shërbimesh në tërë zonën e dedikuar për ofrimin e shërbimeve;

6.2 Rregullatori i përcakton kushtet plotësuese sipas nevojës të cilat zbatohen për lejen për shërbime, që përfshijnë por që nuk kufizohen vetëm në:

(a) kushtet e lejes për shërbime;



- (b) të drejtën për të përtëritur lejen për shërbime;
- (c) kërkesën që ofruesi i shërbimeve të lidhë marrëveshje për menaxhim dhe veprime me ofruesin e shërbimeve i cili është i caktuar me planin për konsolidim si ofrues i shërbimeve në rajonin i cili e përfshin zonën e shërbimeve të ofruesit të shërbimeve, të miratuar nga Rregullatori;
- (d) kufizimin e lejes për shërbime në ndonjë zonë të caktuar të shërbimeve;
- (e) kërkesën që ofruesi i shërbimeve të lidhë marrëveshje me komunën ose komunat që ndodhen në zonën përkatëse të shërbimeve;
- (f) kërkesën ose kufizimin tjetër që është i përshtatshëm për krijimin e një mjedisi me shërbime konkurruese pa krijuar pengesë për konsumatorët dhe për çmimin dhe cilësinë e shërbimeve dhe
- (g) datën kur kushtet e caktuara për leje për shërbime në pajtim me këtë nënmen do të shqyrtohen nga Rregullatori.

6.3 Rregullatori i shqyrton kushtet e caktuara të lejes për shërbime në pajtim me nenin 6.2 në datën e përcaktuar për shqyrtim në pajtim me nenin 6.2(g) dhe në çdo vit në këtë datë ose në ndonjë kohë tjetër që mund të përcaktohet me ndonjë marrëveshje nga neni 6.4.

6.4 Rregullatori mund të lidhë marrëveshje me shkrim me ofruesin e shërbimeve përkitazi me kushtet e lejes së tij për shërbime, duke përfshirë ndryshimin, plotësimin ose zëvendësimin e kushteve të përgjithshme që vlejnë për lejen e tij për shërbime në pajtim me nenin 38.1(b).

6.5 Rregullatori mund të ndryshojë, plotësojë ose zëvendësojë cilatdo kushte të caktuara për leje për shërbime në pajtim me nenin 6.4 pas shqyrtimit të këtyre kushteve për së paku tridhjetë (30) ditë pune pas njoftimit me shkrim të ofruesit të shërbimeve. Në njoftim theksohet natyra dhe shtrirja e ndryshimit, plotësimit ose zëvendësimit dhe koha e plotfuqishmërisë.

6.6 Ofruesi i shërbimeve u përmbahet kushteve të lejes së tij për shërbime gjatë gjithë kohës.

## Neni 7

### Përfundimi dhe revokimi i lejes

7.1 Leja për shërbime përfundon në fillim të:

- (a) ditës së fundit të afatit për të cilin është lëshuar ose
- (b) datës në të cilën leja për shërbime është tërhequr nga Rregullatori,
- (c) datës në të cilën leja për shërbime është kthyer.

7.2 Rregullatori mund ta revokojë lejen nëse:

- (a) ofruesi i shërbimeve në afatin prej dy (2) muajve prej datës së pagesës nuk i ka paguar pagesat ose gjobat administrative që i paguhen Rregullatorit në pajtim me këtë Rregullore;
- (b) ofruesi i shërbimeve ka bërë shkelje nga neni 32 dhe ato shkelje nuk janë përmirësuar para skadimit të kohëzgjatjes së paralajmërimit të përcaktuar në paralajmërimin e nxjerrë nga Rregullatori lidhur me ato shkelje;
- (c) ofruesi i shërbimeve nuk i është përmbajtur ndonjë lejeje, pëlqimi apo autorizimi tjetër të nevojshëm të cilën e kërkon ndonjë organ;
- (d) ekziston ndonjë ndryshim në kontrollin ose pronësinë e ofruesit të shërbimeve;
- (e) drejtori menaxhues i ofruesit të shërbimeve nuk është më drejtor menaxhues i ofruesit të shërbimeve dhe zëvendësimi i pranueshëm për Rregullatorin nuk është emëruar brenda gjashtë (6) muajve prej datës kur drejtori menaxhues nuk është më në këtë pozitë;
- (f) zbatohet ndonjë kamatë sigurie për ndonjë pasuri që është e rëndësishme për sigurimin e shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve;
- (g) ndonjë person merr në posedim, ose ndonjë proces fillohet apo zbatohet ndaj ose parashtrahet ankesë kundër një pasurie që është e rëndësishme për sigurimin e shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve ose
- (h) janë inicuar veprime ose procedura ligjore apo janë marrë hapa tjerë për falimentimin ose likuidimin e ofruesit të shërbimeve apo për ta shpallur atë josolvent.

7.3 Ofruesi i shërbimeve mund ta kthejë lejen e tij për shërbime pasi ta ketë njoftuar Rregullatorin me shkrim gjashtë (6) muaj përpara.

7.4 Rregullatori ndërmerr masa të arsyeshme për të siguruar se ofrimi i shërbimeve nuk ndërprehet në rast se leja për shërbime është ose mund të kthehet apo revokohet, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në bashkëpunimin me organet përkatëse kompetente për të parandaluar ndërprerjen e shërbimeve.

## Neni 8 Taksat e Rregullatorit

8.1 Ofruesi i shërbimeve i paguan Rregullatorit taksën e pakthyeshme për paraqitjen e kërkesës në ditën kur kërkesa për lëshimin ose përtëritjen e lejes për shërbime i është dorëzuar Rregullatorit.

8.2 Ofruesi i shërbimeve i paguan Rregullatorit shumën që nuk është më e madhe se një e gjysëm për qind (1.5%) e qarkullimit bruto të raportuar në llogaritë vjetore të fitimit dhe

humbjeve të kontrolluara në emër të taksës vjetore për leje në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta. Kësti i parë duhet të paguhet në ditën e parë të muajit kalendarik pas muajit në të cilin leja për shërbime i është lëshuar ose përtëritur ofruesit të shërbimeve kurse secili nga këstet e radhës duhet të paguhet në ditën e parë të secilit muaj pasues kalendarik.

8.3 Taksa vjetore për leje caktohet ashtu që të ketë lidhje me shpenzimet të cilat Rregullatori i parashikon t'i bëjë në lidhje me lëshimin dhe monitorimin e lejeve për shërbime sipas planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor të përgatitur nga Rregullatori për vitin kalendarik në të cilin duhet të paguhet këto taksa vjetore për leje.

8.4 Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për zhvillim ekonomik dhe rindërtim, në përputhje me rekomandimet e Rregullatorit, nxjerr udhëzime administrative me anë të të cilave e cakton lartësinë e taksave që duhet të paguhet në pajtim me këtë nen apo metodën e llogaritjes së këtyre taksave.

### **Kapitulli 3 Tarifat për shërbime**

#### Neni 9

#### Përputhshmëria me tarifat për shërbime

9.1 Ofruesi i shërbimeve cakton pagesën për konsumatorët e tij për shërbimet e veta në përputhje me tarifat për shërbime të caktuara ose miratuara nga Rregullatori në përputhje me këtë Rregullore.

9.2 Furnizuesi i ujit të papërpunuar cakton pagesën për ofruesit e shërbimeve për furnizimin e ujit të papërpunuar në përputhje me tarifat e ujit të papërpunuar të përcaktuara ose të miratuara nga Rregullatori në përputhje me këtë Rregullore.

#### Neni 10

#### Caktimi dhe shqyrtimi i tarifave

10.1 Secili ofrues i shërbimeve ose furnizues i ujit të papërpunuar duhet të bëjë kërkesë te Rregullatori në mënyrën e përcaktuar nga ai në pajtim me rregullat e nxjerra sipas nenit 38.1(a) për miratimin e çdo tarife ose ndryshimeve të ndonjë tarife të miratuar.

10.2 Rregullatori i cakton tarifat ose me kërkesë të ofruesit të shërbimeve apo furnizuesit të ujit të papërpunuar i miraton ato ose ndonjë ndryshim të tarifave të ofruesit të shërbimeve apo furnizuesit të ujit të papërpunuar pas konsultimit me komisionin konsultativ të konsumatorëve.

10.3 Tarifa ose ndonjë ndryshim i tarifës përcaktohet në përputhje me rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1(c) kurse sa i përket kritereve të mëposhtme cilado që është e zbatueshme:

(a) shpenzimet marginale afatgjate për ofrimin e shërbimeve përkatëse dhe ndonjë kriter ekonomik i përshtatshëm që zakonisht zbatohet për llogaritjen e tarifave për shërbime të ngjashme në Bashkimin Evropian;

(b) efikasiteti i ofruesit të shërbimeve i matur me anë të krahasimit me treguesit kryesorë të përmbushjes së punës të përcaktuar në rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1(c);

(c) shpenzimet e ofrimit të lidhjes për shërbimet përkatëse janë paguar nga përfituesi i atyre shërbimeve dhe se nuk janë mbuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga përfituesit tjerë të shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve;

(d) mjaftueshmëria e tarifës për shërbime për të mbuluar shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes të ofruesit të shërbimeve dhe të ndonjë plani të ofruesit të shërbimeve për shpenzime kapitale të cilat janë miratuar nga Rregullatori;

(e) nevoja, nëse ekziston, për të harmonizuar tarifën për shërbime që zbatohet për shërbimet e ofruara për ekonomitë familjare në një zonë me popullatë prej jo më shumë se pesë qind (500) dhe ekonomive familjare në zona me popullatë më të dendur në kuadër të të njëjtës zonë të shërbimeve;

(f) përgjegjësia e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, jo e ofruesve të shërbimeve, për t'iu ndihmuar konsumatorëve me të ardhura të ulëta që t'i paguajnë faturat e tyre;

(g) nevoja për parashikimin e një tarifë bazë për shërbime e cila llogaritet në shpenzimet e prodhimit e që e mbulon sasinë minimale të ujit që është e mjaftueshme dhe e sigurtë për përdorim personal dhe shtëpiak dhe për të parandaluar sëmundjet;

(h) metoda sipas së cilës ofruesi i shërbimeve e cakton ose propozon caktimin e tarifës për shërbime;

(i) shkalla deri në të cilën ofruesi i shërbimeve gjatë periudhës 12 mujore paraprake:

(i) i ka ofruar shërbimet e veta në përputhje me standardet e zbatueshme për shërbime;

(ii) i ka plotësuar të gjitha standardet përkatëse për mjedisin të zbatueshme në Kosovë;

(iii) i ka zvogëluar sasinë e ujit të pashitur;

(iv) e ka rritur numrin e përgjithshëm të faturave të dërguara konsumatorëve dhe përqindjen e të gjitha faturave të arkëtuara.

(j) tarifa që duhet të paguhet nga ofruesi i shërbimeve në pajtim me nenin 8.2 dhe

(k) tarifa për ujin e papërpunuar e cila merr parasysh shpenzimet e furnizimit të ujit të papërpunuar të ofruesit përkatës të shërbimeve dhe një shkallë të përshtatshme të fitimit për furnizuesin e ujit të papërpunuar.

10.4 Rregullatori mund të lidhë marrëveshje me shkrim me ofruesin e shërbimeve ose furnizuesin e ujit të papërpunuar për të ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar rregullat që zbatohen për caktimin e tarifave në pajtim me nenin 38.1(c), duke përfshirë mënyrën se si dhe kur mund të ndryshohen këto tarifa pas konsultimit me komisionin konsultativ të konsumatorëve.

10.5 Pas konsultimit me komisionin konsultativ të konsumatorëve, tarifa shqyrtohet nga Rregullatori në përputhje me rregullat e nxjerra sipas nenit 38.1(c) çdo vit, në datën e caktuar ose të miratuar nga Rregullatori apo në cilëndo kohë tjetër të përcaktuar me ndonjë rregull ose marrëveshje me ofruesin e shërbimeve ose furnizuesin e ujit të papërpunuar.

## **Kapitulli 4** **Standardet e shërbimeve**

### Neni 11 Standardet e shërbimeve

11.1 Standardet e shërbimeve që zbatohen për secilin prej shërbimeve përcaktohen me anë të rregullave të nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1(d). Rregullat për standardet e shërbimeve përfshijnë si vijon:

- (a) Për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit:
  - (i) Cilësinë e ujit të furnizuar sipas standardeve të caktuara nga organet kompetente të shëndetit publik;
  - (ii) Shtypjen e ujit nëpër gypa;
  - (iii) Disponueshmërinë e ujit në kuadër të secilës periudhë të caktuar që do të shqyrtohet (mesatarja ditore, mujore dhe vjetore);
  - (iv) Numrin e ndërprerjeve dhe ndalesave të përkohshme të shërbimeve të ujësjellësit në cilëndo periudhë referente të caktuar të shqyrtuar nga Rregullatori;
  - (v) Kohën e nevojshme për hetimin dhe riparimin e rrjedhjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe
  - (vi) Kohën e shqyrtimit të kërkesave për shërbimet e ujësjellësit dhe të kryerjes së instalimit të lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit.

- (b) Për ofrimin e shërbimeve të kanalizimit:
  - (i) Shpeshtësinë e pastrimit të kanalizimit;
  - (ii) Shpeshtësinë dhe kohën për riparimin e rrjedhjeve dhe përmytjes së sistemit për mbledhjen e ujërave të kanalizimit dhe
  - (iii) Kohën e përpunimit të kërkesave për shërbimet e kanalizimit dhe të kryerjes së instalimit të lidhjeve në sistemin për mbledhjen e ujërave të kanalizimit.
- (c) Për ofrimin e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave:
  - (i) Orarin dhe shpeshtësinë e mbledhjes së mbeturinave;
  - (ii) Dendësinë e konteinerëve komunal;
  - (iii) Administrimin e vendit ku mblidhen mbeturinat dhe
  - (iv) Parandalimin e copërave të mbeturinave të shthurura nga shkapërderdhja.
- (d) Për ofrimin e shërbimeve të hedhjes së mbeturinave:
  - (i) Identifikimin dhe përcaktimin e sasisë së mbeturinave të dërguara;
  - (ii) Orarin e punës së deponive dhe vendeve tjera për hedhjen e mbeturinave;
  - (iii) Sigurinë e vendit dhe procedurat e administrimit dhe
  - (iv) Matjen e sasisë së mbeturinave të ngurta.

11.2 Standardet e shërbimeve i shqyrton Rregullatori në përputhje me rregullat e nxjerra sipas nenit 38.1(d) çdo vit në datën e nxjerrjes së këtyre rregullave apo në cilëndo kohë tjetër të përcaktuar me ndonjë rregull ose marrëveshje nga neni 11.3.

11.3 Rregullatori mund të lidhë marrëveshje me shkrim me ofruesin e shërbimeve për të ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar rregullat që zbatohen për standardet e shërbimeve në pajtim me nenin 38.1(d) ose për hollësitë e këtyre standardeve të shërbimeve.

## Neni 12

### Përputhshmëria me standardet e shërbimeve

Varësisht nga neni 13, ofruesi i shërbimeve i përmbahet standardeve të shërbimeve të cilat zbatohen për ato shërbime.

Neni 13Përfshirjet për ndonjë ofrues të shërbimeve

13.1 Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë prej Rregullatorit që të përfshihet prej ndonjë standardi të caktuar për shërbime në mënyrën e përcaktuar nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1(d).

13.2 Rregullatori mund ta përfshijë me shkrim ndonjë ofrues të shërbimeve prej përputhshmërisë me standardet e shërbimeve, duke marrë parasysh të drejtat e konsumatorëve të përcaktuara në Statutin e konsumatorëve dhe në varësi të kushteve të cilat Rregullatori i konsideron të përshtatshme pas konsultimit me komisionin konsultativ të konsumatorëve.

13.3 Çfarëdo përfshirje që i akordohet ofruesit të shërbimeve në pajtim me nenin 13 për ndonjë afat i cili e kalon një (1) vit kalendarik shqyrtohet nga Rregullatori pas një viti në datën kur është akorduar ky përfshirje si dhe në çdo përvjetor pas kësaj.

**Kapitulli 5****Statuti i konsumatorëve**Neni 14Statuti i konsumatorëve

14.1 Të drejtat dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve ndaj njëri tjetrit përcaktohen me rregulla të nxjerra nga Rregullatori në pajtim me neni 38.1(e) dhe me kontratën për shërbime.

14.2 Statuti i konsumatorëve përgatitet në përputhje me dispozitat e Konventës ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore për të siguruar:

(a) qasje në sasinë minimale të domosdoshme të ujit e cila është e mjaftueshme për përdorim personal dhe shtëpiak dhe për parandalim të sëmundjeve;

(b) të drejtën për qasje në ujë dhe stabilimentet dhe shërbimet e ujësjellësit në baza jodiskriminuese duke pasur parasysh ndonjë grup të konsumatorëve në pozitë të pafavorshme dhe të marginalizuar;

(c) qasje të rregullt dhe të sigurtë në bazë të kushteve të sigurta dhe jo në kohë të ndaluar pritjeje në stabilimentet dhe grykëderdhjet e furnizimit me ujë;

(d) shpërndarje të drejtë të të gjitha stabilimenteve dhe shërbimeve të ujësjellësit në dispozicion;

(e) qasje të tërë popullatës së Kosovës në shërbime adekuate sanitare për parandalimin e sëmundjeve që lidhen me ujin dhe

(f) qasje graduale të tërë popullatës së Kosovës në shërbimet e ujësjellësit dhe në ato sanitare në baza të drejta dhe jodiskriminuese.

14.3 Secili ofrues i shërbimeve i përmbahet obligimeve të veta në bazë të Statutit të konsumatorëve dhe kontratës për shërbime.

#### Neni 15 Kontratat për shërbime

15.1 Secili ofrues i shërbimeve, brenda katër (4) muajve pas datës kur Statuti i konsumatorëve hyn në fuqi, lidh kontratë me secilin prej konsumatorëve ku përcaktohen kushtet e përgjithshme sipas të cilave ai do t'ua ofrojë shërbimet konsumatorëve.

15.2 Secila kontratë për shërbime është në përputhje me Statutin e konsumatorëve dhe përpilohet në mënyrën e përcaktuar nga Rregullatori në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe, sipas nevojës, në ndonjë gjuhë tjetër të cilën e flasin numër i konsiderueshëm i konsumatorëve në ndonjë lokacion në kuadër të zonës për shërbime.

#### Neni 16 Regjistri i konsumatorëve

16.1 Secili ofrues i shërbimeve e krijon dhe e mirëmban listën e konsumatorëve të cilët kanë lidhur kontratë për shërbime (regjistri i konsumatorëve) në përputhje me rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1(f) dhe e mbron fshehtësinë dhe përdorimin e drejtë të të dhënave që ruhen në regjistrin e konsumatorëve.

16.2 Ofruesi i shërbimeve e shënon në regjistrin e konsumatorëve nëse ndonjë prej konsumatorëve është person i rrezikuar apo nëse në objektin që e posedon konsumatori jeton ndonjë person i rrezikuar, duke bërë çmos për të siguruar që asnjë prej konsumatorëve të rrezikuar të mos lihet i pashënuar si i tillë në regjistrin e konsumatorëve.

#### Neni 17 Komisionet konsultative të konsumatorëve

Rregullatori themelon nga një komision konsultativ të konsumatorëve për secilën zonë të shërbimeve në bashkërendim me komunën përkatëse, ofruesin përkatës të shërbimeve dhe AKM-në me qëllim të:

- (i) konsultimit të konsumatorëve për ndonjë çështje me rëndësi përkitazi me ofrimin e shërbimeve dhe



- (ii) zgjidhjes së ankesave të parashtruara nga konsumatorët të cilat nuk janë trajtuar si duhet nga sektorët ose kuadrat përkatëse të ofruesit të shërbimeve për shërbimin e konsumatorëve.

## **Kapitulli 6**

### **Ndërprerja nga shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit**

#### Neni 18

##### Ndërprerjet e ndaluara

18.1 Asnjë ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit nuk mund t'ia ndërpresë ndryshe shërbimin personit nga mënyra e paraparë në kontratën e shërbimeve sipas kësaj Rregulloreje apo bazuar në cilatdo rregulla përkritazi me ndërprerjet e nxjerra në pajtim me nenin 38.1 (g). Kjo Rregullore dhe cilatdo rregulla të nxjerra në pajtim me nenin 38.1 (g) shfuqizojnë shprehjet dhe kushtet kundërthënëse në kontratën e shërbimeve lidhur me ndërprerjet.

18.2 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit nuk mund të ndërprejë ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit për objektin e personit të rrezikuar, pos në rastin kur personi i tillë i nënshtrohet ndërprerjes kolektive.

18.3 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund të bëjë ndërprerjen e shërbimeve nëse:

- (a) ka mendim të arsyeshëm se vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit paraqet rrezik të dretpërdrejtë për jetën a shëndetin e cilitdo personi fizik;
- (b) një ndërprerje e tillë kërkohet për qëllime operationale apo të mirëmbajtjes ose
- (c) kërkesa për ujë e tejkalon ofertën.

Me kusht që të jenë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për largimin e rrezikut ndaj jetës apo shëndetit të personave të rrezikuar të shkaktuar nga ndërprerja e tillë dhe, në rastin e paraparë në paragrafin (c) më lart, që ndërprerje e tillë është bërë vetëm pasi që ofruesi i shërbimit ka kursyer ujin në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme në bazë të aftësisë së tij teknike.

#### Neni 19

##### Bazat për ndërprerje

19.1 Me kërkesë të konsumatorit, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit bën ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit të ofruara në përputhje me kontratën për shërbime për objektin ku banon konsumatori.

19.2 Me kërkesë të konsumatorit, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit bën ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit të ofruara në përputhje me kontratën për shërbime për objektin pronë e të cilit është konsumatori, por që është i banuar nga personi tjetër, nëse:

- (a) banuesi është pajtuar se objekti mund të ndërpritet apo
- (b) është dërguar paralajmërimi për ndërprerje të objekteve të parapara për ndërprerje në përputhje me nenin 20.2.

19.3 Sipas nenit 20.1 dhe në pajtim me nenet 20.2 dhe 20.3, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund ta ndërprejë konsumatorin nëse:

- (a) konsumatori ka shkelur kontratën e shërbimeve, me kusht që konsumatori të ketë qenë i informuar për shkeljen e tillë dhe që nuk ka bërë evitimin e saj brenda një kohe të arsyeshme të paraparë për atë qëllim;
- (b) konsumatori nuk paguan faturën apo nuk hyn në marrëveshje për pagesë të faturës brenda një muaji kalendarik nga data kur ajo faturë duhet të paguhet;
- (c) konsumatori nuk e bën pagesën e kërkuar në pajtim me marrëveshjen për pagesë pas paralajmërimit dhe pas mundësisë së arsyeshme për bërjen e pagesës së tillë;
- (d) objekti është i lidhur në mënyrë të paligjshme;
- (e) konsumatori refuzon ta lejojë përfaqësuesin e ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të identifikuar në mënyrë të duhur përmes kartelës me fotografi të tij, të ketë qasje në objektet e tij për të instaluar a lexuar njëhësorin apo për të inspektuar ose riparuar cilëndo pasuri të ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit në objektet e konsumatorit;
- (f) ekziston një rrjedhje e jashtme dhe e dukshme në objektin e konsumatorit të cilën konsumatori nuk e ka riparuar apo nuk është marrur vesh me ofruesin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit për ta riparuar brenda pesë (5) ditëve të punës nga paraqitja e kërkesës me shkrim për ta bërë këtë ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- (g) konsumatori nuk ka paguar paradhënien në datën e pagesës;
- (h) ka baza të arsyeshme për të besuar se konsumatori ka shfrytëzuar shërbimet e ujësjellësit në mënyrë të pandershme;
- (i) cilido person ka shfrytëzuar shërbimet e ujësjellësit të ofruara për konsumatorin për qëllim të paautorizuar;
- (j) rrjeti i shpërndarjes së shërbimeve të ujësjellësit është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes së madhe ose të shkatërrimit apo
- (k) objektet që duhet të ndërpritin nuk janë të banuara.

Neni 20  
Procedura e ndërprerjes

20.1 Para se ta ndërprejë konsumatorin, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit bën përpjekje të arsyeshme që konsumatori i cili ka shkelur kontratën e shërbimeve apo nuk ka paguar faturën e pakontestueshme a një shumë në datën e pagesës në pajtim me marrëveshjen për pagesë kërkon të respektojë kontratën për shërbime apo ta bëjë pagesën e kërkuar.

20.2 Pos në rastin e ndërprerjeve për arsyet e parapara në nenet 18.3 (a), 19.1 apo në 19.3 (j) dhe (k), ofruesi i shërbimeve dërgon paralajmërimin me shkrim përkitazi me ndërprerjen (paralajmërimi për ndërprerje) në adresën për faturim dhe, nëse është ndryshe, në objektet që duhet të ndërpriten, së paku 10 (dhjetë) ditë pune para datës kur do të bëhet ndërprerja. Nëse objekti që duhet të ndërpritet është ndërtesë me shumë njësi, paralajmërimi vëhet në hyrje të ndërtesës dhe i shpërndahet secilës njësie në ndërtesë.

20.3 Paralajmërimi për ndërprerje dërgohet në shqip, serbisht, anglisht e nëse ka nevojë në cilëndo gjuhë tjetër që flitet më shumë nga konsumatorët në cilindo vend brenda rajonit të ofrimit të shërbimeve dhe përmban si në vijim:

- (a) Datën kur objekti do të shkyçet,
- (b) Arsyen për ndërprerje dhe çfarë veprimi konsumatori apo banuesi i objektit mund të ndërmarrë për parandalimin e ndërprerjes,
- (c) Kushtet dhe procedurat për rikyçjen e objektit pas ndërprerjes,
- (d) Mekanizmat ligjorë apo administrativë për ankesa, të cilat konsumatori i ka në dispozicion për të reaguar kundër ndërprerjes, që ka ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të parapara në këtë Rregullore apo në cilatdo rregulla të nxjerra nga Rregullatori në pajtim me të,
- (e) Dënimet të cilat konsumatori apo banuesi i pëson nëse i rikyç objektet në shërbimet e ujësjellësit në mospërputhje me procedurat e parapara në paralajmërimin për ndërprerje,
- (f) Tarifat që paguhen në pajtim me nenin 28 dhe
- (g) Nëse arsyeja për ndërprerje është mospagesa e faturës së pakontestuar, paradhënies apo e pagesës së paraparë sipas marrëveshjes për pagesë:
  - (i) Shumën e gjithëmbarshme që kërkohet të paguhet dhe kohën për të cilën shuma e tillë duhet të pranohet nga ofruesi i shërbimeve në mënyrë që të parandalohet shkyçja,
  - (ii) Një listë të specifikuar për shumën e borxheve ndaj ofruesit të shërbimeve,

(iii) Informata lidhur me atë se si të bëhet marrëveshja për pagesë me ofruesin e shërbimeve apo se si të kontestohet një faturë dhe

(iv) Adresa e orari i punës së zyrës ku duhet të bëhet pagesa.

20.4 Shkyçja bëhet nga së paku dy (2) punëtorë të ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit të identifikuar siç duhet me një kartelë me fotografi të tij apo të saj.

20.5 Shërbimi i ujësjellësit nuk shkyçet jashtë orarit të punës apo në ditën e cila nuk është ditë pune.

20.6 Ofruesi i shërbimit të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund të kërkojë ndihmën e policisë dhe të KFOR-it për të kryer ndërprerjen nëse punëtorëve të tij u mohet qasja në objekt me forcë fizike apo me kërcënim me forcë fizike.

### Neni 21 Ndërprerjet kolektive

21.1 Asnjë ofrues i shërbimeve nuk mund të bëjë ndërprerjen kolektive të grupit të caktuar pos në rastin kur shprehimisht autorizohet nga Rregullatori.

21.2 Ndërprerjet kolektive lejohen nëse kryhen në përputhje me kushtet e kësaj rregulloreje dhe me rregullat e nxjerra në pajtim me nenin 38.1 (g), si dhe nëse ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund të paraqesë në mënyrë të kënaqshme për Rregullatorin se:

(a) Grupi i konsumatorëve të cilin ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit e propozon për ndërprerje është grup i caktuar apo

(b) Ofruesi i shërbimeve është penguar fizikisht për leximin e njuhësorit ose për kryerjen e aktiviteteve të mirëmbajtjes brenda zonës së caktuar ose

(c) Ka një numër të kyçjeve të paligjshme a rikyçjeve siç është përshkruar në nenin 26 në rajonin specifik gjeografik që:

(i) Paraqesin pjesën më të madhe të të gjitha kyçjeve në atë rajon gjeografik dhe

(ii) Ndikojnë dukshëm në aftësinë e ofruesit të shërbimeve për të menaxhuar sistemin.

21.3 Kërkesës së ofruesit të shërbimeve për përdorimin e procedurave të ndërprerjes kolektive e cila i dërgohet Rregullatorit, i bashkëngjiten dëshmi të mjaftueshme dhe të verifikueshme ashtu siç kërkohen nga Rregullatori, e që mbështesin me prova kushtet nga neni 21.2.

21.4 Me rastin e parashtrimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndërprerjen kolektive, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, në mes çështjeve tjera të kërkuara nga rregullat e nxjerra në pajtim me nenin 38.1 (g), i ofron Rregullatorit informatat si në vijim:

- (a) Nëse ndërprerja kolektive përfshinë një rajon të caktuar gjeografik dhe pikën në rrjetin e shërbimit të ujësjellësit ku do të bëhet ndërprerja kolektive,
- (b) Numrin dhe përqindjen e konsumatorëve të pandërgjegjshëm brenda grupit të caktuar,
- (c) Kopjet e të gjitha faturave të pakontestueshme, kushtet e secilës marrëveshje për pagesë dhe çfarëdo kërkesash lidhur me pagesën apo ekstrakte përkatëse të dokumenteve për secilin konsumator të grupit të caktuar,
- (d) Dëshminë që ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit ka bërë si në vijim:
  - (i) Ka lëshuar shpallje publike për periudhën mes tri (3) dhe pesë (5) ditëve të punës para ndërprerjes kolektive të propozuar, duke cekur se kur do të bëhet ndërprerja kolektive, rajonin gjeografik ku do të bëhet ajo dhe të drejtën e cilitdo konsumatori të ndërgjegjshëm për të kërkuar kompensim sipas kësaj rregulloreje,
  - (ii) Ka lajmëruar me shkrim përfaqësuesit rajonal të Shtyllës II të UNMIK-ut, AKM-në dhe komunën në rajonin gjeografik ku ndërprerja kolektive e propozuar do të bëhet.

#### Neni 22

#### Procedurat për ndërprerjet kolektive

Ndërprerjet kolektive bëhen në përputhje me rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1 (g) dhe me procedurat si në vijim:

- (a) Periudha fillestare e ndërprerjes zgjat jo më shumë se dyzet e tetë (48) orë,
- (b) Pas kryerjes së periudhës fillestare të ndërprerjes, ofruesi i shërbimeve rikyç shërbimet për një periudhë jo më pak se dyzet e tetë (48) orë,
- (c) Nëse pas rikyçjes së shërbimit, faktet që kanë arsyetuar ndërprerjen ende ekzistojnë, ofruesi i shërbimeve do të bëjë ndërprerjen e dytë për një periudhë tjetër dyzet e tetë (48) orëshe të pasuar me rikyçjen tjetër për një periudhë tjetër jo më pak se dyzet e tetë (48) orëshe,
- (d) Nëse pas përfundimit të periudhës së dytë, arsyet për ndërprerje kolektive ende ekzistojnë, ofruesi i shërbimeve, pas miratimit të Rregullatorit, bën ndërprerjen me kohëzgjatje

të pacaktuar duke marrë parasysh në mënyrë të duhur dhe duke bërë ofrimin për konsumatorët e ndërgjegjshëm, të cilët janë të prekur nga ndërprerja,

(e) Nëse në çfarëdo kohe gjatë procedurës së ndërprerjes arsyet për ndërprerje kolektive ndryshojnë në mënyrë që kriteret për ndërprerje kolektive të mos ekzistojnë më, ofruesi i shërbimeve menjëherë e ndal procesin për ndërprerje kolektive dhe vazhdon me furnizim dhe

(f) Pas përfundimit të procedurave për ndërprerje kolektive të përshkruara në këtë nen, të gjithë konsumatorët që janë anëtarë të grupit të caktuar më parë dhe të cilët nuk kanë përmbushur obligimet ndaj ofruesit të shërbimeve u nënshtrohen procedurave të ndërprerjes individuale ashtu siç është përshkruar me këtë Rregullore.

### Neni 23

#### Kontesti i vullnetit të mirë

Në rast të kontestit të vullnetit të mirë, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit nuk bën ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit me kusht që konsumatori i paguan ofruesit të shërbimeve pjesën më të vogël të:

- (a) Shumës së faturës së pakontestuar, nëse ekziston ajo, apo
- (b) Shumën mesatare të të gjitha faturave të pakontestueshme për:
  - (i) Gjashtë (6) muajtë e kaluar, nëse shërbimet janë ofruar për një (1) vit ose më shumë a
  - (ii) Në çfarëdo rasti tjetër, tre (3) muaj të kaluar.

### Neni 24

#### Kyçjet e paligjshme

24.1 Asnjë objekt nuk mund kyçet në mënyrë të paligjshme.

24.2 Sipas nenit 24.3, banuesi i cilitdo objekti që është i kyçur në mënyrë të paligjshme obligohet t'ia paguajë ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit si në vijim:

- (a) Dënimin në shumë prej njëqind (100) euro,
- (b) Shpenzimet e riparimit të kyçjes së objektit në shërbimet e ujësjellësit, të cilat nuk mund të jenë më të mëdha se sa shpenzimet e kyçjes së konsumatorëve të rinj dhe
- (c) Shpenzimet e ujit, për të cilin ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, pas konsultimit me Rregullatorin, vlerëson se i është ofruar objektit nga 1 janari 2002, ose nëse banuesi mund të ofrojë dëshmi të kënaqshme se nuk ka shfrytëzuar objektin në mënyrë të vazhdueshme nga ajo datë për periudhën gjatë së cilës objekti ka qenë i shfrytëzuar nga banuesi.

24.3 Banori i cilitdo objekt, i cili është i kyçur në mënyrë të paligjshme, nuk obligohet për dënime dhe shpenzimet e parapara në nenin 24.2, nëse brenda periudhës së faljes, banuesi:

(a) Paraqet kyçjen e paligjshme në rrjetin e ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe

(b) Hyn në marrëveshje për shërbim me ofruesin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

24.4 Cilatdo dënime a shpenzime të pagueshme nga konsumatori sipas nenit 24.2 mund t'i shtohen faturës së konsumatorit.

24.5 Asgje në këtë nën nuk ndikon në aftësinë e autoritetit kompetent për të ndërmarrë masa sipas ligjit të aplikueshëm kundër pronarit apo banuesit të cilitdo objekti, i cili është i kyçur në mënyrë të paligjshme.

#### Neni 25

##### Rikycja e bërë nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit

25.1 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit e rikyç objektin e konsumatorit jo më vonë se dy (2) ditë pune pasi që konsumatori të ketë paguar të gjitha shumatat me kohë ndaj ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

25.2 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund të refuzojë furnizimin e shërbimeve të ujësjellësit për konsumatorin, i cili në vazhdimësi nuk ia ka paguar shumatat ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe mund të refuzojë rikyçjen e konsumatorit të tillë e ta heq lidhjen e konsumatorit në shërbimet e ujësjellësit. Cilado rikycje e mëvonshme e objektit, qoftë me kërkesë të konsumatorit apo të ndonjë personi tjetër, trajtohet si kyçje e re dhe nuk do të ndikojë në detyrimet e konsumatorit përkitazi me shumatat e papaguara ndaj ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

25.3 Refuzimi i ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit në përputhje me nenin e lartshënuar 25.2 duhet të arsyetohet në mënyrë të duhur me shkrim dhe duhet të ofrojë informata lidhur me mjetet juridike dhe administrative në dispozicion të konsumatorit për ta kundërshtuar një vendim të tillë.

#### Neni 26

##### Rikyçjet e paligjshme

26.1 Cilido person, pos ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, i cili rikyç cilindo objekt në shërbimin e ujësjellësit pas ndërprerjes, i nënshtrohet dënimeve të parapara nga Rregullatori. Cilido dënim, që sipas këtij neni paguhet nga konsumatori, mund t'i shtohet faturës së konsumatorit.

26.2 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund t'i konfiskojë të gjitha pajisjet e shërbimit të ujësjellësit, duke përfshirë tërë pajisjet njëhësuese të përdorura në objektet që vazhdimisht rikyçen në shërbimet e ujësjellësit në kundërshtim me nenin 26.1.

### Neni 27 Paradhëniet

27.1 Nëse kërkohet nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, konsumatori më parë i shkyçyr paguan shumën e cila nuk kalon dyfishin e faturës mesatare mujore si paradhënie për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit (paradhënia).

27.2 Sipas nenit 27.3, pagesa e paradhënies nuk ndikon në obligimin e konsumatorit për pagesën e shumave të tjera ndaj ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit në pajtim me kontratën e shërbimeve.

27.3 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund të zbatojë paradhënien për cilëndo shumë të pagueshme nga konsumatori nëse mospagesa e tillë rezulton me ndërprerjen e konsumatorit.

### Neni 28 Taksat dhe kompenzimet

28.1 Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit mund të kërkojë pagesën e taksave, shuma e të cilave duhet të aprovohet nga Rregullatori në pajtim me nenin 10 si në vijim:

- (i) Lëshimin e paralajmërimit për ndërprerje,
- (ii) Ndërprerjen,
- (iii) Rikyçjen e objekteve pas ndërprerjes dhe
- (iv) Legalizimin e kyçjes së paligjshme, shuma e së cilës nuk mund të jetë më e madhe se shpenzimet për kyçjen e konsumatorëve të ri.

28.2 Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit nuk iu përmbahet procedurave për ndërprerje të parapara në këtë Rregullore ose në rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1 (g), çdo konsumator i prekur ka të drejtë për kompensim adekuat të konsideruar si të duhur për kompensimin e dëmit ndaj konsumatorit, i cili duhet të llogaritet dhe të paguhet ashtu siç përcaktohet kohë pas kohe nga Rregullatori.

28.3 Në rastin e ndërprerjes kolektive, kur ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit bën ndërprerjen e konsumatorit të ndërgjegjshëm, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit kompenzon konsumatorin duke kredituar faturat e tij të ardhshme me një shumë sa dyfishi i mesatares së shumës të cilën konsumatori do ta kishte përdorur po të mos shkyçej apo duke paguar kompensimin e tillë në para të gatshme kurdo që shkyçja kolektive të zgjasë më shumë se tre (3) muaj kalendarik.



Neni 29Ankesat drejtuar Komisionit konsultativ të konsumatorëve

29.1 Cilido konsumator i prekur nga shkyçja apo nga shkyçja kolektive ndaj të cilit nuk është vepruar në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje apo ndaj të cilit ofruesi i shërbimeve ka bërë shkeljen e të drejtave të tjera të parapara në statutin e konsumatorëve dhe në kontratën e shërbimeve, mund të parashtrojë ankesë tek ofruesi i shërbimeve të ujës-jellësit dhe të kanalizimit, i cili ka bërë ndërprerjen ose ndërprerjen kolektive të tillë apo tek ofruesi i shërbimeve, i cili ka shkelur të drejtat e tilla.

29.2 Nëse konsumatori i cili ka parashtruar ankesë tek ofruesi i shërbimeve të ujës-jellësit dhe të kanalizimit në pajtim me nenin 29 nuk beson se ankesa e tij është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme nga ana e ofruesit të shërbimeve brenda një muaji kalendarik nga data kur ankesa ka arritur tek ofruesi i shërbimeve, atëherë konsumatori mund t'ia referojë çështjen me shkrim Komisionit konsultativ të konsumatorëve, që gjendet në rajonin e shërbimit, në mënyrë që ai ta zgjidh.

## **Kapitulli 7**

### **Borxhet**

Neni 30Falja dhe pagesa e borxheve nga e kaluara

30.1 Ofruesi i shërbimeve mundet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje t'i falë borxhet e konsumatorit nga e kaluara në përputhje me nenin 30.2 dhe me rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1 (h), me kusht që konsumatori i tillë:

- (a) Ka hyrë në kontratë për shërbime,
- (b) Ka paguar apo ka hyrë dhe ka respektuar marrëveshjen për pagesë me ofruesin e shërbimeve për cilëndo shumë të borxhit nga e kaluara, e cila nuk mund të falet në pajtim me nenin 30.2 dhe
- (c) Nëse është e rëndësishme, i ka paraqitur çfarëdo kyçje të paligjshme ofruesit të shërbimeve.

30.2 Borxhet nga e kaluara, të cilat konsumatorit i falen në pajtim me nenin 30.1 (h) janë si në vijim:

- (a) Shumat e faturuara para 31 dhjetorit 2000 dhe
- (b) Nëse konsumatori nuk është institucion apo administratë publike a qeveri ose person ndërkombëtar, pesëdhjetë për qind (50%) të shumave të faturuara prej 1 janarit 2001 deri më 31 dhjetor 2001.

Neni 31  
Marrëveshjet për pagesë

31.1 Konsumatori i cili nuk ka paguar faturat që i ka borxh ofruesit të shërbimeve mund të kërkojë në përputhje me rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.1 (h) nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit që të hyjë në marrëveshje për pagesën e faturave të tilla në këste, me kusht që konsumatori t'i paguajë të gjitha faturat e ardhshme që vijnë nga ofruesi i shërbimeve sapo që atyre t'iu vijë afati i pagesës.

31.2 Nëse cilido këst i pagueshëm sipas marrëveshjes për pagesë nuk paguhet brenda një muaji kalendarik nga data kur duhet të paguhet kësti i tillë, e tërë shuma e papaguar sipas marrëveshjes për pagesë menjëherë bëhet e pagueshme përpos nëse ka masa të tjera për të cilat është arritur marrëveshja me konsumatorin për të kompensuar këtë mospagesë.

31.3 Kushtet e secilës marrëveshje për pagesë, të cilën ofruesi i shërbimeve e jep, konfirmohen me shkrim dhe dërgohen në adresën e faturimit të konsumatorit brenda pesë (5) ditëve pune nga ofrimi i marrëveshjes së tillë.

**Kapitulli 8**  
**Zbatimi**

Neni 32  
Shkelja e sanksioneve administrative

32.1 Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobë administrative deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro nëse:

- (a) Ofron shërbimin pa pasur licencën për shërbim,
- (b) I ofron Rregullatorit informata të falsifikuara, çorientuese apo të pasakta duke ndikuar që Rregullatori të lëshojë a të ripërtëritë licencën për shërbim,
- (c) Nuk i respekton kushtet e licencës për shërbim të tij apo të standardeve për shërbim dhe duke vepruar kështu shkakton rrezik për:
  - (i) Shëndetin apo jetën e njerëzve,
  - (ii) Mjedisin apo
  - (iii) Mjetet themelore të nevojshme për ofrimin e shërbimeve,
- (d) Furnizon me ujë të papërshtashëm për përdorim nga njerëzit ose
- (e) Ndërprenë ofrimin e shërbimit pa ndonjë arsye të pranueshme për Rregullatorin.

32.2 Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobën administrative deri në 20.000 (njëzet mijë) euro nëse:

(a) Përsërit apo shkelë në vazhdimësi obligimet e tij themelore të identifikuara dhe të parapara në rregullat e nxjerra nga Rregullatori në pajtim me këtë rregullore ose

(b) Në mënyrë të paligjshme diskriminon cilindo person a grup të personave.

32.3 Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobën administrative deri në 5.000 (pesë mijë) euro nëse:

(a) Nuk i përmbahet kësaj rregulloreje në cilatdo raste të tjera pos atyre të parapara në nenet 32.1 dhe 32.2 apo cilësdo rregull të nxjerrë nga Rregullatori në pajtim me këtë rregullore ose

(b) Kërkon tarifa të cilat nuk janë paraparë dhe miratuar në përputhje me këtë rregullore.

32.4 Vjelja e çfarëdo gjobe administrative për cilëndo shkelje të paraparë në këtë nen nuk e liron ofruesin e shërbimeve nga obligimi për të evituar shkeljen e tillë a për të kompensuar konsumatorin e dëmtuar në përputhje me këtë rregullore ose cilatdo rregulla të nxjerra nga Rregullatori në pajtim me nenin 38.

### Neni 33 Paralajmërimi

33.1 Nëse Rregullatori, pas kryerjes së hetimeve të arsyeshme, vie në përfundim se ofruesi i shërbimeve ka bërë shkelje në pajtim me nenin 32, ose që licenca për shërbim duhet t'i merret për arsyet e parapara në nenin 7.2, dërgon një paralajmërim për ofruesin e tillë të shërbimit (paralajmërimi), i cili cek si në vijim:

(i) Karakterin e shkeljes të cilën ofruesi i shërbimeve besohet ta ketë bërë, dëshmitë që mbështesin mendimin se një shkelje e tillë është bërë, gjobën administrative dhe pasojat e mundshme të shkeljes së tillë ose

(ii) Arsytet se pse Rregullatori beson se licenca për shërbime duhet të merret dhe rrethanat të cilat justifikojnë marrjen e tillë nëse nuk evitohen brenda periudhës së specifikuar nga Rregullatori në paralajmërimin me shkrim,

(iii) Se Rregullatori mund të gjobisë ofruesin e shërbimeve apo, nëse është e rëndësishme, t'ia merr licencën e shërbimit nëse rrethanat që kanë ndikuar në shkelje ose të cilat justifikojnë marrjen e licencës për shërbime nuk evitohen brenda kohëzgjatjes së paralajmërimin dhe

(iv) Se ofruesi i shërbimeve ka afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune për t'i parashtruar një deklaratë me shkrim Rregullatorit përkitazi me çdo çështje të cilat dëshiron të

merren parasysh në mbrojtje të tij, siç janë faktet që zbusin përgjegjësinë e tij dhe ndonjë dëshmi tjetër e rëndësishme.

33.2 Në fund të kohëzgjatjes së paralajmërimit, Rregullatori lëshon vendimin për ofruesin e shërbimeve, në të cilin ceket si në vijim:

(a) Se a është bërë shkelja dhe a ekzistojnë rrethanat që kanë sjell deri te shkelja dhe a janë evituar ashtu siç kërkohet nga Rregullatori ose

(b) Nëse rrethanat që justifikojnë marrjen e licencës për shërbime a janë evituar ashtu siç kërkohet nga Rregullatori dhe

(c) Nëse rrethanat që kanë sjell shkeljen ose justifikimin e marrjes së licencës për shërbime nuk janë evituar ashtu siç kërkohet nga Rregullatori:

(i) Shumën e cilësdo gjobë administrative dhe afatin e pagesës,

(ii) Se licenca për shërbime është marrë dhe

(d) Të drejtën e ofruesit të shërbimeve për t'ia parashtruar kërkesën brenda një (1) muaji Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar vendimin.

33.3 Çdo gjobë administrative e shqiptuar ndaj ofruesit të shërbimeve në pajtim me nenin 32 duhet t'i paguhet Rregullatorit:

(a) Një muaj (1) pas datës së lëshimit të vendimit nga Rregullatori apo

(b) Nëse ofruesi i shërbimeve i ka parashtruar kërkesën Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar vendimin e tillë, ditën kur Komisioni shqyrtues merr vendimin e tij.

33.4 Kamata sipas shkallës vjetore (sh.v.) prej pesë për qind (5%) llogaritet për çdo shumë të papaguar sipas nenit 32 dhe i shtohet asaj shume në ditën e parë të secilit muaj.

#### Neni 34 Komisioni shqyrtues

34.1 Ofruesi i shërbimeve mund t'i parashtrojë kërkesë Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar çdo vendimi të sjellë nga Rregullatori në pajtim me nenin 33, me kusht që kërkesa të jetë bërë me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga data e vendimit të Rregullatorit. Për t'i ikur dyshimit, urdhërat dhe rregullat e lëshuara nga Rregullatori në pajtim me këtë Rregullore gjithashtu i nënshtrohen shqyrtimit nga ana e Komisionit shqyrtues, nëse ofruesi i shërbimit parashtron kërkesën për një shqyrtim të tillë.

34.2 Komision shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i emëruar nga Zëvendëspërfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për rindërtim dhe zhvillim ekonomik, një anëtar i emëruar nga Rregullatori dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim.

34.3 Komisioni shqyrtues miraton procedurën, e cila zbatohet gjatë marrjes parasysh të çështjeve të referuara për Komisionin shqyrtues.

34.4 Pas shqyrtimit të prezentimeve të ofruesit të shërbimeve dhe të Rregullatorit, Komisioni shqyrtues i jep ofruesit të shërbimeve dhe Rregullatorit një vendim të hollësishëm me shkrim brenda një (1) muaji, i cili publikohet, me kusht që çdo informacion sipas të cilit do të mund të identifikohet konsumatori, ndonjë punonjës i ofruesit të shërbimeve apo Rregullatori, të mos jipet pa pëlqimin e atij personi.

### Neni 35 Shqyrtimi gjyqësor

35.1 Çdo ofrues i shërbimeve mund t'i parashtojë kërkesë gjyqit kompetent në Kosovë për shqyrtim gjyqësor të vendimit të Komisionit shqyrtues në pajtim me nenin 34.3, me kusht që kërkesa e tillë të bëhet brenda një (1) muaji nga data kur ofruesi i shërbimeve është paraqitur me shkrim për vendimin përkatës nga Komisioni shqyrtues. Gjatë shqyrtimit të vendimit të tillë, gjykata nuk zëvendëson diskrecionin administrativ të Rregullatorit me të vetin.

35.2 Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga gjykata kompetente pezullimin e vendimit të Rregullatorit për marrjen e licencës nëse ofruesi i shërbimeve ka për qëllim të parashtojë kërkesën për shqyrtim dhe mund të vërtetojë se efektet e marrjes së tillë të licencës nga Rregullatori do të ishin të pariparueshme në rast se vendimi anulohet në periudha të mëvonshme nga Komisionit shqyrtues apo nga gjykata kompetente. Çdo pezullim i tillë përfundon pas marrjes së vendimit nga Komisioni shqyrtues a gjykata kompetente ose, nëse ndodh më herët, pas skadimit të periudhës gjatë së cilës ofruesi i shërbimeve duhet t'i parashtojë kërkesën për shqyrtim Komisionit shqyrtues ose gjykatës.

35.3 Në rast se gjykata vendos se ofruesi i shërbimeve nuk ka qenë fajtor për shkeljen apo e zvogëlon gjobën administrative më parë të shqiptuar ndaj tij, Rregullatori i kthen tërë shumën ose pjesën kryesore të shumës të cilën e ka pranuar si gjobë administrative së bashku me kamatë prej një për qind në vit (1% sh.v).

## **Kapitulli 9** **Të ndryshme**

### Neni 36 Përjashtimet

36.1 Neni 3 nuk vlen për asnjë ofrues të shërbimeve, i cili ofron shërbime në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, me kusht që ofruesi i tillë i shërbimeve apo furnizuesi i ujit me shumicë ka parashtruar kërkesën te Rregullatori për licencën për shërbime dhe për miratimin e tarifave të tij brenda tridhjetë (30) ditëve pune nga data kur kjo Rregullore hyn në fuqi dhe nëse nuk është arritur vendimi nga Rregullatori për kërkesën e tillë.

36.2 Nenet 11.1 dhe 14.2 nuk vlejnjë për asnjë ofrues të shërbimeve, i cili ofron shërbime, deri njëzet (20) ditë pune pas datës kur Rregullatori i nxjerr rregullat dhe formularët e paraparë të cekur në nenin 38.1 (c).

Neni 37  
Komunikatat me shkrim

37.1 Sipas kësaj Rregulloreje, Rregullatori mund t'i dërgojë komunikata me shkrim, me postë ose përmes korierit, ofruesit të shërbimeve ose furnizuesit të ujit me shumicë në adresën e fundit, e cila i jipet Rregulatorit nga ofruesi i shërbimeve ose nga furnizuesi i ujit me shumicë.

37.2 Komunikata me shkrim dërguar ofruesit të shërbimeve në përputhje me nenin 37.1 konsiderohet si e pranuar nga ofruesi përkatës i shërbimit apo nga furnizuesi i ujit me shumicë brenda pesë (5) ditëve pune nga data kur Rregullatori mund të dëshmojë se është dërguar.

Neni 38  
Rregullat e nxjerra nga Rregullatori

38.1 Brenda dy muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullatori nxjerr rregulla dhe formularë të paraparë përkitazi këtë si në vijim:

- (a) Kërkesat për lëshim, ripërtëritje apo dorëzim të licencës për shërbime,
- (b) Kushtet e përgjithshme të licenses për shërbime,
- (c) Caktimin dhe miratimin e tarifave,
- (d) Standardet e shërbimeve të cilat zbatohen për çdo shërbim (standardet për shërbim) dhe çdo përjashtim për secilin prej tyre,
- (e) Të drejtat dhe obligimet e ofruesit të shërbimeve dhe të konsumatorëve të tyre në përgjithësi (Statuti i konsumatorëve) dhe formularin standard për kontratën e shërbimeve,
- (f) Regjistrin e konsumatorëve,
- (g) Ndërprerjet , ndërprerjet kolektive dhe çështjet tjera përkitazi me kyçjen e objekteve në shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe
- (h) Faljen apo pagesën e borxheve nga e kaluara dhe marrëveshjet për pagesë.

38.2 Pas konsultimeve me komunat, AKM-në dhe ofruesit e shërbimeve, Rregullatori nxjerr rregulla për themelimin e komisioneve konsultative dhe për caktimin e funksioneve e procedurave operationale brenda tre (3) muajve nga data kur kjo Rregullore hyn në fuqi.

38.3 Çdo ndryshim, shtesë apo zëvendësim në rregullat e nxjerra sipas nenit 38.2 hyn në fuqi pas konsultimit me palët përkatëse, sipas mënyrës për të cilën është pajtuar Rregullatori, komunat, AKM-ja dhe ofruesit e shërbimeve.

38.4 Rregullatori mundet në çdo kohë t'i ndryshojë, t'i shtojë apo t'i zëvendësojë rregullat dhe formularët e paraparë të nxjerrë në pajtim me nenin 38.1, me kusht që t'i paralajmërojë me

shkrim ofruesit e shërbimeve së paku tridhjetë (30) ditë pune më parë. Paralajmërimi i tillë cek karakterin e ndryshimit, të shtesës apo të zëvendësimit dhe datën kur hyn në fuqi.

38.5 Rregullatori ofron falas një kopje të rregullave të nxjerra sipas kësaj Rregulloreje dhe të çdo ndryshimi, shtese ose zëvendësimi të atyre rregullave për secilin ofrues të shërbimeve si në vijim:

- (a) Në datën kur ofruesi i shërbimeve e fiton licencën për shërbim,
- (b) Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita kur rregullat e tilla janë nxjerr, janë ndryshuar, shtuar, apo zëvendësuar ose
- (c) Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita kur Rregullatori pranon kërkesën nga ofruesi i shërbimeve për një kopje të rregullave të tilla, të ndryshimeve, të shtesave a zëvendësimeve të rregullave të tilla.

#### Neni 39

#### Ndalimi i diskriminit të paligjshëm

Ofruesi i shërbimeve nuk mund të diskriminojë në mënyrë të paligjshme asnjë person në çfarëdo bazash përkitazi me çështjet e parapara në këtë Rregullore apo në rregullat e nxjerra në pajtim me nenin 38.

#### Neni 40

#### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 26 nëntor 2004.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm